

Tiranë, 24.08.2021

PARLAMENTI I RI 2021-2025

RISITË DHE SFIDAT KRYESORE TË LEGJISLATURËS SË RE

Për vetëm disa ditë Presidenti i Republikës do të dekretojë datën e mbledhjes së seancës së parë të legjislaturës së re parlamentare. Praktika kushtetuese e mbledhjes së parlamentit parashikon seancën e hapjes dhe të verifikimit të mandateve, si dhe zgjedhjen e drejtuesve të rinj të Kuvendit, seanca që drejtohen nga deputeti më i vjetër në moshë.

Në vlerësimin e Institutit të Studimeve Politike (ISP), në dallim nga legjislaturat e mëparshme kjo legjislaturë ka disa risi dhe të dhëna të veçanta, ka prurje të reja më të shumta në numër sesa legjislatura e mëparshme dhe ka pritshmëri më të mëdha publike. Legjislatura do të nis me dorëheqje të katër deputetëve, përfshirë kryetari i Kuvendit, si dhe pritet të ketë ndryshime të tjera në listën finale të deputetëve sipas rezultatit zgjedhor: Në javën e dytë të shtatorit pritet të mandatohet dhe të krijohet qeveria e re, e treta e PS prej vitit 2013.

Praktika parlamentare maj-korrik 2021, gjatë të cilës Shqipëria kishte paralelisht një parlament të zgjedhur dhe një parlament në detyrë, si dhe praktika 2019-2021 me parlament pa opozitë reale dhe me vetëm 122 deputetë, ndonëse kanë dobësuar rolin e parlamentit në sistemin politik dhe në pozitën kushtetuese të tij, sipas vlerësimit të ekspertëve të ISP, janë indice të forta për të kthyer vëmendjen tek legjislatura e re, reformimi i sistemit përfaqësues dhe një qasje të re më institucionale në jetën parlamentare dhe politike.

ZGJEDHJET DHE STATITIKA TË PËRFAQËSIMIT

Më 25 prill 2021 u zhvilluan zgjedhjet e dhjeta parlamentare prej 1991. Më 13 korrik 2021 KQZ miratoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

- Rezultatet zyrtare konfirmuan Partinë Socialiste në pushtet. Partitë e opozitës kontestuan rezultatin dhe adresuan ankime të shumta lidhur me standardet e munguara

zgjedhore dhe pretendimet për manipulime. Në traditën postkomuniste, vetëm 3 nga 7 procese zgjedhore parlamentare janë pranuar nga të gjitha palët politike, (1992, 2005, 2013).

- Zgjedhjet e vitit 2021 ishin të parat që i dhanë mandat të tretë rrallazi një partie politike dhe të shtatë procese zgjedhore ku një parti e vetme fiton shumicën e mandateve në parlament (1991, 1992, 1996, 1997, 2001, 2017, 2021). Zgjedhjet 2021 ishin zgjedhjet e para pas situatës unike: bojkotit kolektiv të opozitës në parlament (2019-2021) shoqëruar me dorëzimin e mandateve parlamentare dhe bojkotit të zgjedhjeve lokale (2019).
- Në zgjedhjet 2021 u aplikua për herë të parë vota e parapëlqyer, me prag të lartë zgjedhor (mbi 10 mijë vota). Në përfundim, vetëm 3 kandidatë arritën të ndryshojnë listat shumëemërore të partive politike duke fituar mandate parlamentare: Orlando Rakipi¹ dhe Fatmir Xhafaj (PS, Tiranë), si dhe Luçiano Boçi (PD, Elbasan).
- Në zgjedhje konkurruan 12 subjekte politike dhe 5 kandidatë të pavarur. Nga lista e subjekteve vetëm 4 subjekte fituan mandate direkt (PS, PD, LSI, PSD), si dhe 6 subjekte jokonkurrese fituan mandate indirekt, duke qenë pjesë e listës shumëemërore të PD (PLL, PBDNJ, PR, PAA, PDIU, LZHK). Asnjë nga kandidatët e pavarur nuk fitoi mandat dhe të gjithë së bashku morën më pak vota sesa numri i firmave mbështetëse që i duhen një kandidati të pavarur për të kandiduar në zgjedhje.
- Lidhur me përfaqësimin rajonal, vlen të theksohet se vetëm në dy qarqe (Shkodër dhe Tiranë) kanë siguruar mandate 4 subjekte politike (PS, PD, LSI, PSD). Në qarkun Fier janë përfaqësuar 3 subjekte (PS, PD, LSI), kurse në 9 qarqet e tjera kanë arritur të kenë përfaqësim politik vetëm dy subjekte, PS dhe PD.
- Nga “opozita parlamentare” 2019-2021 arritën të rizgjidhen deputetë vetëm dy, Lefter Koka (ish LSI, fitues në listën e PS Durrës) dhe Autora Mara (ish LSI, fituese në listën e PS Dibër). Në total 12 deputetë të “opozitës parlamentare” u përfshinë në listat shumëemërore të dy partive të mëdha, 9 në listën e PS dhe 3 në listën e PD. Një deputet kandidoi në listën e LSI, ndërsa 20 deputetë të “opozitës parlamentare” nuk kandiduan në zgjedhjet 2021. Nga pjesa tjetër, tri partitë me përfaqësim në opozitën parlamentare 2019-2021, partitë e përfaqësuara ose të drejtuara nga M.Murrizi, R.Hajdari dhe A.Permeti, etj, nuk arritën 1% të votave dhe mbeten jashtë parlamentit të ri.

¹ Vlen të theksohet se Rakipi është prurje e re, pa përvojë politike dhe CV publike, i deleguar në listën e PS nga babai i tij, ish deputeti Aqif Rakipi, një mbështetës i rëndësishëm politik i kryeministrit Rama dhe një prej ish deputetëve që më 2018 ka humbur mandatin parlamentar për shkak të ligjit të dekriminalizimit.

TË DHËNA STATISTIKORE MBI PARLAMENTIN E RI 2021-2025

- Parlamenti i ri do të ketë 140 deputetë, nga të cilët 74 PS, 50 PD, 4 LSI, 3 PSD, 3 PR, 2 PDIU, 1 PLL, 1 LZHK, 1 PBDNJ, 1 PAA². Për të pasur mazhorancë qeverisëse duhen 70+1 deputetë, pra PS e vetme ka numrin e nevojshëm të mandateve për të qeverisur e vetme. Nga pjesa tjetër e përfaqësimit parlamentar, 3 votat e PSD janë vota mbështetëse për PS edhe për shkak se 3 kandidatët fitues janë zyrtarë dhe aktivistë lokalë të PS Shkodër. Në këtë mënyrë, PS pritet të ketë 77 vota të përhershme në parlament. Pjesa tjetër e partive mbeten (aktualisht) në opozitë.
- Legjislatura e re parlamentare është e vetmja në historinë e pluralizmit që nis me ndryshim rrënjësor të ekipit drejtues të legjislaturës paraardhëse. Asnjë nga tre anëtarët e kryesisë së Kuvendit 2017-2019 dhe asnjë nga 10 anëtarët e Byrosë së Kuvendit (2017-2019) nuk është rizgjedhur më 25 prill 2021. Një numër gjithashtu i madh i kryetarëve të komisioneve, të sekretarëve dhe të strukturave të tjera në Kuvend, nuk janë rizgjedhur ose nuk kanë kandiduar në këto zgjedhje. Ky është ndryshimi më i thellë sasior i ekipit drejtues të Kuvendit në 5-6 legjislaturat e fundit parlamentare.
- Për shkak të kriterit të integritetit në politikë, një deputet (Tom Doshi, PSD) dha dorëheqje nga mandati menjëherë pas rizgjedhjes së tij. Në qershor dha dorëheqje nga politika dhe jeta parlamentare edhe kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi (PS). Gjatë muajve korrik-gusht janë rritur zërat kritikë që mbështesin kërkesën amerikane për largimin nga parlamenti edhe të deputetit Sali Berisha (PD), i përfshirë në listën e zezë amerikane. Deputeti Gledis Çeliku (PSD), refuzoi në maj 2021 formularin e dekriminalizimit, duke pasjell humbjen e mandatit parlamentar pas dorëheqjes së T.Doshi. I njëjti deputet është rizgjedhur edhe në legjislaturën e re dhe pritet të shihet nëse në shtator do të pranojë mandatin parlamentar. Nga kontaktet me partitë politike rezulton se ka edhe deputetë të tjerë që mund të japin dorëheqje nga mandati, për shkak të dekriminalizimit, duke zgjedhur të mbajnë angazhimet profesionale ose postet ekzekutive që kanë aktualisht.
- Në legjislaturën e re janë zgjedhur 48 deputete ose 34% e parlamentit, një shifër që tejkalon kuotën gjinore prej 30% të vendosur nga partitë politike dhe që është 6% më shumë sesa në parlamentin e vitit 2017. Nga subjektet politike PS ka 28 gra deputete, PD 17, LSI 2 dhe PSD 1, ose në përqindje, PS 38%, PD 29%, LSI 50% dhe PSD 33%. Vlen të theksohet se asnjë nga

² Sipas të dhëna zyrtare të KQZ: Agron Duka (PAA) ishte në listën shumëemërore të PD Durrës; Fatmir Mediu (PR), ishte në listën shumëemërore të PD Tiranë; Lindita Metaliaj (PR) ishte në listën shumëemërore të PD Lezhë; Eralda Tase (PR) ishte në listën shumëemërore të PD Fier; Vangjel Dule (PBDNJ) ishte në listën shumëemërore të PD Tiranë; Shpëtim Idrizi (PDIU) ishte në listën shumëemërore të PD Tiranë; Dashamir Shehi (LZHK) ishte në listën shumëemërore të PD Tiranë; Andia Ulliri (PLL) ishte në listën shumëemërore të PD Durrës; Nusret Avdulla (PDIU) ishte në listën shumëemërore të PD Fier.

kryesia e fundit në parlament e Aleancës së Grave deputete nuk u kandidua në zgjedhje dhe nuk do të jetë pjesë e parlamentit të ri.

- Në parlamentin e ri deputetët më të vjetër në moshë janë Luljeta Bozo (PS, 78 vjeç), Sali Berisha (PD, 77 vjeç) dhe Tritan Shehu (PD, 72 vjeç). Vetëm 2 nga 140 deputetët janë në moshë nën 30 vjeç, përkatësisht Orlando Rakipi (PS, 27 vjeç) dhe Andia Ulliri (PD-PLL, 22 vjeç). Deputeti më i vjetër në moshë do të ketë të drejtën e hapjes dhe drejtimit të dy seancave të para të parlamentit në shtator 2021.
- Në total, vetëm 1 deputet i parlamentit të ri ka 9 mandate përfaqësimi në parlament, (Berisha, PD), 2 kanë nga 8 mandate (Braçe PS dhe Shehu PD), 1 ka 7 mandate, (Dule PBDNJ), 3 kanë nga 6 mandate, 5 nga 5 mandate, 10 nga 4 mandate, 20 nga 3 mandate, 30 nga 2 mandate dhe 68 deputetë zgjidhen për herë të parë, pra me 1 mandat parlamentar. Ripërtëritja me 49% e parlamentit është një trend në rritje ndaj shumicës së legjislativave të fundit parlamentare. Për evidencë, 55% të deputetëve të zgjedhur për herë të parë i përket grave deputete dhe 45% gjinisë tjetër.
- Lidhur me formimin profesional, parlamenti i ri ka 38 deputetë me tituj shkencorë, nga të cilët 5 me titull Prof. Dr; 4 me titull Profesor i Asociuar, 24 doktorë shkencash dhe 5 doktorantë. Lidhur me përfaqësimin gjinor, 43% e grave deputete kanë tituj shkencorë, ndaj vetëm 19% të deputetëve meshkuj. Vetëm një deputet deklaroi se vijon studimet universitare, të gjithë deklarohen me arsim të lartë, përfshirë edhe diploma në universitete të mbyllura për shkak të informalitetit në arsimin e lartë.
- Lidhur me profesionet bazë të deputetëve , 37 nga 140 deputetë janë diplomuar në degë të ndryshme të studimeve ekonomike, 30 janë diplomuar në drejtësi, 13 në inxhinieri, 7 për gjuhë të huaja, 5 për administrim biznes, 4 në shkollë ushtarake apo policore, nga 3 në agronomi, shkenca politike dhe kimi, etj. Dy deputetë janë diplomuar në arte, një prej të cilëve është kryeministri Rama. Krahasuar me legjislativën e kaluar është rritur numri i deputetëve me njohuri ekonomike dhe ka rënë numri i deputetëve me formim juridik.
- Në total, 61% e deputetëve të parlamentit të ri janë banorë të Tiranës, vetëm 39% banojnë në zonat zgjedhore jashtë kryeqytetit, kryesisht në zonat afër Tiranës (Durrës, Elbasan, etj). Lidhur me përkatësinë fetare të deputetëve, të bazuar në të dhënat e CV të tyre (jo në deklarime të konfirmuara individuale), 75% i përkasin besimit mysliman, 14% besimit ortodoks dhe 11% besimit katolik.

SFIDAT KRYESORE TË PARLAMENTIT TË RI

- **Funksionaliteti i parlamentit:** Akti më i rëndësishëm i parlamentit të ri është pritshmëria mbi pjesëmarrjen konstruktive të opozitës në jetën parlamentare. Pas bojkoteve periodike dhe dorëzimit kolektiv të mandateve më 2019, pjesëmarrja e opozitës dhe funksionimi normal i parlamentit përbëjnë kushtin dhe sfidën kryesore për legjislaturën e re. PD ka lajmëruar pjesëmarrje të rregullt, megjithatë ende nuk ka një vendim të pakushtëzuar zyrtar. Parlamenti i ri përballet me sfidën të jetë funksional dhe të fokusohet në axhendën klasike parlamentare, synim që mund të vij në kontrast me axhendat afatshkurtra të mazhorancës (për të marrë vendime selektive me shumicë votash duke injoruar kritikën dhe prezencën e opozitës) dhe të opozitës (për ta bazuar përfaqësimin në retorikë kritike e denigruese dhe jo në praktika ligjëbërëse dhe funksione kontrolluese të qeverisë dhe parlamentit).
- **Lidhur me procesin e integritetit dhe reformën në drejtësi:** Në aspektin politik, parlamenti i ri do të duhet/pritet të ketë prioritet një axhendë të re lidhur me integritetin e vendit në BE në prirje të konferencës së parë BE - Shqipëri, si dhe të ndërhyjë në Kushtetutë për të zgjidhur mosmarrëveshjet lidhur me mandatet kushtetuese të strukturave të vettingut (mandati i të cilave skadon në korrik 2022). Për qëllimin e parë parlamenti do të përballet me sfidën për të krijuar unison përfaqësimi në politikën e jashtme dhe për të pasur qëndrime të përbashkëta lidhur me progresin e Shqipërisë drejt BE. Praktika sipas të cilës konflikti i brendshëm politik zhvendoset në kancelaritë perëndimore ka rezultuar e gabuar, jo efektive dhe dëmtoese për vendin. Nga ana tjetër, parlamenti ka rol thelbësor për ecurinë e reformës në drejtësi. Ai duhet të shqyrtojë mundësinë për ndërhyrje në Kushtetutë lidhur me mandatet e KPK & Misionit Ndërkombëtar, por edhe për ndërhyrje përmirësuese në legjislacionin aktual të reformës.
- **Mandatet parlamentare.** Debati kryesor në shtator pritet të lidhet me mandatin e z.Berisha si deputet, pas kërkesës së palës amerikane për largimin e tij nga parlamenti. PD nuk ka ende një vendim zyrtar, ndërkohë që zoti Berisha vazhdimisht ka bërë të qartë se mbetet aktiv edhe në legjislaturën e re. Zoti Berisha ka ndikim direkt në një pjesë të grupit parlamentar të PD, si dhe në përqindje më të lartë tek anëtarësia militante dhe strukturat lokale të saj. PD pritet të marrë një vendim të ndërmjetëm dhe jo përfundimtar përpara nisjes së legjislaturës së re dhe pas zgjedhjes së kryesisë dhe sekretariatit të ri. E njëjta situatë dhe vendimmarrje pritet edhe për disa raste të tjera parlamentare në secilin krah kryesor politik.
- **Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit.** Në aspektin përfaqësues do të ketë rëndësi individi i zgjedhur nga PS për të pasur z.Ruçi si kryetar i parlamentit, si dhe oferta e mazhorancës për ndarje me opozitën të drejtimit të jetës parlamentare. Disa negociata indirekte midis palëve gjatë muajit korrik për dhënien e drejtimit të parlamentit opozitës, nuk kanë pasur sukses.

Zgjedhja e një figure të moderuar nga PS do të ishte lajm i mirë për funksionalitetin e parlamentit. Nga ana tjetër, zgjedhja e ndonjë figure militante partiake, do të ishte investim për dobësim të rolit të parlamentit dhe për konflikt permanent parlamentar midis mazhorancës dhe opozitës.

- **Reforma e re zgjedhore:** Një prej temave kryesore që pritet të trajtojë parlamenti i ri janë standardet e zgjedhjeve dhe reforma e re zgjedhore, përfshirë edhe reforma në legjislacionin mbi partitë politike. Sipas praktikës, gjithnjë legjislaturat kanë nisur me debate të tilla për të çuar më pas në krijimin e një komisioni të ri për reformën zgjedhore. I njëjti zhvillim pritet edhe në sesionin e ri parlamentar.
- **Raporti President – mazhorancë:** Presidenti aktual është shkarkuar nga parlamenti i kaluar dhe është në pritje të vendimmarrjes nga Gjykata Kushtetuese. Ai ka moderuar sjelljen e tij politike, por konflikti kushtetues dhe politik mbetet. Presidenti do të duhet të dekretojë qeverinë e re të drejtuar nga Rama, i cili ka votuar shkarkimin e tij dhe se dy palët kanë kontestuar legjitimitetin reciprok. Sjellja e palëve në këtë proces kushtetues dhe emergjent (java e dytë e muajit shtator), do të testojë edhe raportet e reja politike paszgjedhore në vend.
- **Zgjedhja e Presidentit më 2022.** Parlamenti i ri do të duhet të zgjedhë Presidentin e ardhshëm (prill-maj 2022). Megjithëse mazhoranca i ka votat e nevojshme për të zgjedhur President kandidatit e saj të preferuar, nevoja për konsensus politik mbetet dominuese dhe në interes strategjik të të gjitha palëve. Zgjedhja konsensuale do të jetë edhe këshillë perëndimore, por jetësimi i kësaj formule është e ndërvarur nga faktorë dhe zhvillime të tjera komplekse brenda parlamentit dhe vetë partive politike. Është e qartë se asnjë parti / faktor me ndikim nuk mbështet rizgjedhjen e Presidentit aktual dhe se shumica e faktorëve mbështetin idenë e ecjes kundër tezës “fituesi i merr të gjitha”.
- **Zgjedhja të reja lokale:** Një temë tjetër që kërkon bisedime politike dhe konsensus parlamentar është nevoja e rikonfigurimit të përfaqësimit politik në qeverisjes vendore. Opozita nuk është pjesë e qeverisjes vendore pas bojkotit të vitit 2019, por nga ana tjetër, janë disa bashki me kryetarë të emëruar dhe në pozita antikushtetuese, për shkak të mosmarrëveshjeve midis Presidentit, qeverisë dhe opozitës. Çdo vendim i GJK në këtë drejtim do të duhet të pasojë zgjidhjen politike, kalimin në zgjedhje të reja të përgjithshme lokale.
- **Dekriminalizimi dhe integriteti:** Parlamenti i ri pritet të ketë në përbërje individë me probleme në rekordet personale në raport me kriteret e integritetit dhe të dekriminalizimit. Në parlamentin e ri ka deputetë të sponsorizuar nga grupe informale dhe në raste të veçanta, edhe grupe me lidhje kriminale, etj, të cilët do të përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e tij. Disa deputetë të “vjetër” dhe prurje të reja janë objekt në dosje të nisura hetimore. Procesi i dekriminalizimit do të vijojë të ketë ndikim dhe të sjellë edhe ndryshime edhe në përbërjen e parlamentit të ri.

- **Pritshmëri minimale dhe mandati i tretë si eksperiment.** Së fundi, PS fitoi zgjedhjet parlamentare, ndryshe nga 2013, pa pasur një program politik / elektoral. Për pasojë, axhenda e parlamentit të ri nuk ka një bazë referuese, por do të bazohet në nismat e mazhorancës, të cilat në dallim nga 2013 dhe 2017, pritet të jenë nisma afatshkurtra dhe konsum ditor më shumë sesa nisma strategjike reformash të programuara. Një parti e vetme që qeveris e vetme në dy nivelet e pushteteve dhe nis mandatin e tretë, e ka të vështirë të kryejë reforma. Çdo vendim reformator do të ishte vendim kundër trashëgimisë së vet politike të 8 viteve të fundit. Publiku nuk ka pritshmëri për reforma, duke marrë të mirëqenë se PS është në pushtet më shumë për paaftësinë e opozitës për tu bërë alternativë sesa për shkak të meritave të saj në standardet e qeverisjes. Në Shqipërinë postkomuniste reformat janë kryer nga mazhorancat në mandatet e para pas rotacionit, mandatet e dyta kanë qenë kryesisht mandate konsumi të pushtetit, mandatet e treta nuk janë provuar ende. Legjislatura 2021-2025 mbetet eksperimentale edhe në këtë drejtim. Për pasojë, parlamenti do të ndeshet me vështirësi në hartimin e axhendës afatgjatë dhe në ushtrimin e funksionit kushtetues të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv dhe jetësimin e procesit ligjvënës.

Hartuar nga @Instituti i Studimeve Politike (ISP)

Instituti i Studimeve Politike (ISP) ka monitoruar aktivitetin parlamentar 2016-2020, fillimisht me mbështetjen e FES (2016), të Ambasadës së Holandës (2017-2020), si dhe do të vijojë monitorimin 2021-2023 me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Monitorimi përfshin raporte periodike, vlerësime mbi Kuvendin, cilësinë e përfaqësimit për çdo deputet e grup parlamentar, rolin e parlamentit në vendimmarrje, si dhe treguesit e transparencës dhe të llogaridhënies në parlament.

ISP do të vijojë monitorimin edhe të aspekteve të tjera që lidhen me parlamentin, mbështetur nga donatorë perëndimorë, siç janë dekriminalizimi në jetën politike dhe publike (2021-2023), konflikti i interesit, si dhe progresi në procesin e integritetit të Shqipërisë (2021-2023).

Ky raport informativ është produkt i angazhimeve të ISP në informimin e publikut mbi progresin demokratik, si dhe nuk është pjesë e ndonjësi projekti mbështetës.